

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"A&M DISTRIBUTION" SHPK

Sot me daten 20.03.2024 ,themeluesi:

Marjus Seiti i biri i Shyqyri,i datelindjes 18.01.1992, lindur ne Lulezim,Tepelene,Shqiperi dhe banues ne Tirane,Shqiperi me Adrese Rr Tom Plezha,Tirane identifikuar me Nr. ID J20118040R.

Ne perputhje me Ligjin nr.9901 Date 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 date 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Ka vendosur te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar " A&M DISTRIBUTION " Shpk.

Neni 1.

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet " A&M DISTRIBUTION " SHPK

Neni 2

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise eshte ne adresen:


Prefektura/Qarku:Tirane,Rrethi:Tirane,Bashkia:Tirane,Qyteti:Tirane,Rruga Muhamet Gjollesha,Njesia me nr. 2/124+1-3/1, ZK 8250 Shoqeria mund te hape filiale te tjera ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe ne te gjitha shtetet jashte territorit te Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

Import-Export produkte kozmetike te ndryshme,produkte te kujdesit vetjak,shitje detergjentesh dhe artikuj te ndryshem pastrimi per shtepi, hotele, zyra, restorante,linja Ho.Re.Ca.Prodhim montim pajisje pastrimi te ndryshme.



Neni 4

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise do jete 100,000 (Njeqind mije)Leke.Pjesemartja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e plote te Z.Marjus Seiti me vlere te pergjithshme prej 100,000 leke.Keto kuota i perkasin ortakut te vetem si me poshte:

1. Marjus Seiti ID Nr. J20118040R zoterues i 1(kuote) me vlere te pergjithshme 100,000 leke perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakut.

Neni 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar.

Neni 6

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Administrator i shoqerise do te jete Z.Marjus Seiti ID Nr. J20118040R, e cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte rizgjedhje.Nje Administrator tjeter mund te emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te trete ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep ortakeve.

Neni 7

VENDIME TE ASAMBLESE SE PERGJITHESHME


Asambleja e pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres.

Vendimet e asamblese se pergjithshme merren bazuar ne perqindjen e kapitalit e zoteruar prej secilit ortak, konform pikes 1 neni 86 i ligjit 9901 dt.14.04.2008 "Per shoqerite Tregtare",

Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjitheshrne regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhen regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.



Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria proven se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi do te shperndahet midis ortakeve respektivisht sipas kuotave te kapitalit themeltar te investuar te shprehura ne nenin 4 te ketij akti. Fitimi i destinuar per tu shperndare perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven ligjore dhe te tjera rezerva statutore , si dhe duke i shtuar apo zbritur respektivisht humbjet e mbartura nga vitet e meparshme.

Neni 9

LIKUIDIMI

Shoqeria eshte ne likuidim e siper qe ne momentin e prishjes se saj, operacion i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne legjislacionin tregtar shqiptar.

Neni 10

MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, Themeluesi do ti drejtohet Gjykates se Rrethit per zgjidhje.

SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“A&M DISTRIBUTION” Shpk

Ortaku Vetem

MARJUS SEITI

Marjush Seiti
